



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo  
Viti/na



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of

## PROCESVERBAL NGA SEANCA E III E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Seancën e ftoi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vitisë, z.Naim Pira . Seanca është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, në Shtëpinë e Kulturës “Gursel e Bajram Sylejmani” në Viti, më 30.03.2015 (e Hënë) në ora 10,<sup>00</sup>. Në seancë prezantuan 24 anëtarë të Kuvendit, munguan tre këshilltarë me arsye. Në seancë ishin prezent Nënkryetari i Komunës Z.Hasan Aliu, Drejtorët e Drejtorive, , përfaqësuesi i OSBE-së, organizata joqeveritare dhe mediat e shkruara dhe elektronike .

**Kryesuesi:** Para se të filloj me punë sipas rendit të ditës i përshëndeti të gjithë të pranishmit, si Nënkryetarin e Komunës, Këshilltarët e Kuvendit, Drejtorët e Drejtorive, Përfaqësuesin e OSBE-së, OJQ-të, Mediat etj. Pas numërimit nga sekretaria të këshilltarëve në sallë kryesuesi konstatoi se kemi kuorum dhe mundemi me filluar me punë të seancës së III të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë. Meqenëse javën e kaluar ka qenë “Flakadani Karadakut” më lejoni tu falënderoj të gjithë këshilltarëve për kontributin që keni dhënë në organizimin e atij manifestimi, i cili konsideroj se ka qenë një manifestim jashtëzakonisht dinjitoze desha për këtë ta komplimentoj edhe drejtoreshën e kulturës për një punë të shkëlqyer dhe një organizim të shkëlqyer e cila ka bërë gjatë atij manifestimi .

Para se të kalojmë në miratimin e rendit të ditës kisha lut këshilltarët a ka ndo kush ndonjë pyetje apo ndonjë propozim , në seancën e kaluar ka pasur një pyetje nga këshilltari i VV në lidhje me taksat dhe ngarkesa kisha lutur drejtorin ta merr fjalën urdhëro drejtor fjala është për ju :

**z.Ajet Sallahu:** Përshëndetje z.Nënkryetar, kryesues drejtor të drejtorive dhe ju këshilltar të nderuar në lidhje me pyetjen që është bërë nga këshilltari është fjala për taksat administrative për leje të ndërtimit për këtë që atë ditë e tha kjo është një pëlqim nga ministria të cilën e lejon taksën 2.47 mirëpo kjo është e datës 11.06 .2013 masë kësaj date në nga ministria nuk ka ardhur në drejtori fare dhe me 23 .09 .2013 në kuvendin e më hershëm ka hyrë në fuqi një

rregullore tjetër përveç kësaj si dhe në 2014 që ka hyrë në fuqi me 1janar 2015 e kemi rregulloren që tash e kemi në fuqi ku i ndan taksat në që aplikohen në qytet i ndan në 3 zona a në fshatra i ndan në 4 zona , sipas ligjit në fuqi mbi ndërtimin nr 04 /L 110 pika 1. 3 organi konkret kompetent duhet ta qoj për konsultim rregulloren por nuk mund ma herët se 6 muaj pa i bërë rregullorja që është në fuqi .

**Kryesuesi: A** ka ndonjë pyetje dikush tjetër apo ndonjë propozim?

**znj.Mirlinda Sadiku:** Fillimisht dua ta shfrytëzoj këtë foltore që të bëjë thirrje se e kam par deklaraten se e ka dhënë kryeministri Isa Mustafa se do ta përkrah fuqimisht anamoravën atëherë të gjithë jemi në dijeni për përmbytjet i fundit që kanë ndodh dhe janë në vazhdimësi duke ndodhur sipas gazetës zyrtare të republikës së Kosovës nr 10 /29 e publikuan në vitin 2013 në nenet 46, 47, 49 deri në nenin 72 aty shumë mirë specifikohet se Komuna dhe autoriteti janë kompetent për rregullimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës mbrojtëse në shtretërit të lumenjve përfshirë edhe pritrat malore edhe pikat tjera mbrojtëse andaj e shfrytëzoj këtë moment dhe bëjë thirrje edhe te qeveria ta kthej kryet ka anamorava edhe të bëjë investim njëherë e përgjithmonë sepse rrezikohet edhe është fakt që nuk janë kryer as mbjelljet pranverore po as mbjelljet vjeshtore edhe jektarrë të tanë kanë mbetur djerrina, ndoshta po bëna e tepërt mirëpo njerëzit kanë filluar me ble edhe bukën e gojës kjo është një çështje tjetër ndërsa këtu i kam dy pyetje edhe një ankesë që vjen nga Fshati Pozheran , sa i përket të parës është se shumë herë në këtë kuvend komunal por edhe në KPF është vënë në dyshim cilësia e punimeve e dua me qenë konkrete këtë e argumentoj se në Fshatin e Ri kodi projektit 90554 shuma e destinuar për këtë projekt ka qenë 8487 euro ku parat janë ri destinua në seancën e dytë të jashtëzakonshme të mbajtur me datë 11.08 .2014, por në teren rezulton se nuk ka gropë septike dhe gypi i kanalizimit derdhet në proçkën që vjen prej Fshatit të Ri kalon nëpër arat e Ramjanit dhe shkon në Pozheran dhe ujërat e zeza derdhën dhe bëjnë dëme në tokat bujqësore dmth ky është projekt që është krye në vitin 2014 atëherë bëjë pyetje pse nuk është ndërtuar një gropë septike dhe pse këto ujëra derdhën në këtë përroskën kur dihet se bimë në kundërshtim edhe me ligjet e rep. Kosovës dhe po ashtu edhe për rregulloren qe e kemi ma vonë me diskutua çështja dytë është e njëjta situatë është me kanalizimin në Skifteraj për hire të korrektësisë më duhet ta them që ky kanalizim është punua në vitin 2004 – 2005 ka qen investim nga bashkimi evropian implementuesi i këtij projekti ka qenë një firmë nga Kamenica dhe po ashtu as lagja Avdiu e lagja Ismajli dhe Haliti nuk janë të kyçura në këtë kanalizim shtrohet pyetja pse ky projekt nuk ka përfundua në tersi pse nuk ka grop septike si lejohet në[ kundërshtim me ligjin për ujërat e Kosovës ku qartë thuhet se ndalohet hudhja e ujërave të zeza në lumenjtë e Kosovës por kjo është edhe një prej standardeve që na me qenë pjesë e bashkësisë Evropiane dhe ky ujë derdhet nëpër arat e fshatrave Gjylekarë Remnik dhe Budrikë. Çështja e tret që do të kisha ngrit edhe do të kisha bërë edhe apel mu ndërmarr diçka është se në Pozheran më konkretisht te proçka se vjen nga Tereza kalon nëpër lagjet Demiri, Halabaku dhe Salihu sjell sasi të madhe të ujit gjatë të reshurave atmosferike gypat të cilat janë të vendosur me kontribut të vetë banorëve nuk e përballojnë sasinë e madhe të ujit dhe shpesh herë që ngrit niveli në këtë përrock ajo shkakton dëme qoftë në rrugë po ashtu edhe në ekonomit familjare prandaj se gjendja në teren nuk është e mirë dhe kjo përrock duhet mu pastrua sepse ky problem po u shkakton banorëve të lagjeve të lart cekura shumë dëme .

**z.Bislim Bislimaj:** Përhëndetje të nderuar të pranishëm para se ta hapim dhe ta shqyrtojmë rendin e ditës kisha mi shpreh disa brenda të qytetarëve të komunës sonë , kjo gjendje sa

dëshpëruese dhe e pa shpresë po na kthen në depresion shumë të thellë që sa po e hupim edhe kuptimin e të qenit këshilltar shpesh edhe po fitojmë armiq pa nevojë , me një sinqeritet të thellë deklaroj se krejt apo vërejtje dhe kritika nuk burojnë nga inati dhe gjelozia për të qenë në ekzekutiv më me endje do të isha merr me lëvdatë që janë bërë për përmirësimin e qytetarëve por ajo nuk është bërë si po e shohim për çdo ditë vinë dhe varfërohen jo pse nuk janë punëtor apo të pa zot por një mënyrë e një sistemi të tillë nuk jep kur far gjase që një ditë do të na qesh fytyra për një vepër të qëlluar , un shpesh herë kam fol dhe kam kritikuar duke besuar se ato kritika do të aprovohen dhe me punën e ekzekutivit do të hiqen një herë e përgjithmonë nga rendi i ditës e të merrmi me probleme të kulturës të artit të shkencës të merrmi me probleme tjera me të cilat merret bota e mbar. Shpeshherë bile nuk kam lan mbledhje pa diskutuar për problemet e zhvillimit ekonomik e në kuadër të saj ne un ka menduar se bazë nga dot të niseshim ne do të ishte bujqësia , edhe pse e dimë se nuk ka ujë të pasur megjithatë një bujk se do t siguronte burimin e vet të ekzistencës do ta pasuronte shtetin do të kisha pasur dëshirë që shumë më shpesh të kemi tema të tilla për të diskutuar, por kjo nuk po ndodh dhe ne këshilltarët po humbim kuptimin gjithnjë e më shumë po heshtim dhe kjo po nënkupton mos veprim .gjendja në qytet she nëpër fshatra jo që nuk është përmirësuar por në disa sektor është përkeqësuar un do të parashtroj disa prej tyre e ju të nderuar kolegë mund nëse e kam pa vend e nëse e kam me vend atëherë vëlla a do të mund ta marr përkrahjen tuaj po filloj me sektorin e bujqësisë dhe të pylltarisë kur para një viti kërkua përgjegjësit e pyetjeve të merren në përgjegjësi për shkak se nuk kanë bërë detyrën e tyre në parandalimin e piromanëve që e dogjën prenë dhe e shkatërruan më tepër se gjysmën e pyllit askush nuk reagoj duke kërkuar përgjegjësi pasojat e kësaj djegie dhe shkatërrimit po i ndjemë sot sepse pylli siç e dimë nuk është vetëm si vend apo burim strategjik i strehimit apo mbrojtjes shfrytëzimit të masës drunore, por edhe në radhë të parë për të mbajtur sasinë e dheut për sistemin rrënjor të bimës duke mos lejuar erozionin dhe duke ndaluar shiun dhe të reshurat tjera që të mos derdhen në fushën tonë shumë pjellore pasojat po shihen shiu i parë që bie në bjeshkë për mungesë të pengesave na rrëmben të mbjellurat e këtë edhe bukën e përditshme, por ne kërkujmë se fushe dhe qyteti të mbrohen me kanale kulluese të cilat nuk janë aq të kushtueshme dhe që kërkojnë pak investime dhe ekzekutivi po i merr se kritik të opozitës dhe po hasët në vesh të shurdhër nuk po merret si obligim për ti bërë një shërbim të popullatës pasojat po shihen po përmendi disa shembuj që lidhen me këto vija kulluese është regjistruar premtimi elektoral për lagjen e muhaxhirëve në Pozheran se do të rregullohet kanalizimi edhe pastrimi i kalanlit, prapa kësaj lagje shembulli tjetër është te proçka që gjendet prapa shtëpisë së kulturës e cila me shiun e parë përmyt jo vetëm qytetin por edhe fushën e tërë në dalje të qytetit dhe kjo me një ndërhyrje me bagerë që e posedon komuna do të ishte rregulluar kjo pjesë . atëherë me të drejt qytetarët pyesin se çfarë është bërë me përmirësimin e bujqësisë edhe mirëqenës së tyre.

Po kaloj pake edhe në sektorin e shëndetësisë a ka barna esenciale kemi këtu mjek dhe qfar është përmirësuar në këtë drejtim për çfarë gjendje janë shërbimet bazike a është përmirësuar diçka po përmendi disa raste më të freska rasti i parë ndeshja e fundit në udhëkryqin e Vitisë me Pozheran për fate të keq aksidenti i një shoferi nga Pozherani se nuk i dolën në ndihmë as ndihma shpejt e as policia a askush nuk guxonte të afrohej ndonjë ndihmë për rrethe 30 minuta e ndërkohë se shtëpia e shëndetit nuk gjendet ma larg se 1 km grumbulli i masës pa me sy të tyre trishtimim njerëzve të cilët kishin nevojë për ndihmë por ata nuk dinin si tu ndihmojnë sepse ligji nuk e lejon viktimën ta prek personi i pa autorizuar dhe krejt qa mund të bënim ishte

që ti qesin ujë për mos me ra në komë rasti i dytë ndeshja në Gerqarë dy të aksidentuar kur arrin ndihma e shpejt personeli nuk ka dorëza në mënyrë që të i jepet ndihma e të aksidentuarit në ndihmë ju del një kalimtar rasti që ju jep doreskat që shkon vetë për ti blerë, ndërsa rasti i sodit gruaja shtatzënë kërkon ndihmë te mjeku nuk ka, 20 cent kushton nuk ka kanil 50 cent kushton sistem nuk ka 40 cent etj pas këtyre shembujsh a mund të shtrojmë pyetjen se në çfarë gjendje jemi në shëndetësi, kur ky shtet do të interesohet për qytetarët e vetë ,

**z.Sejdi Emini:** Këto se po i thotë asamblisti nuk janë vetëm fjalë janë fakte argumente që po i sjell ky kuvend nuk po i thotë me dashje po pi thotë prej presionit që ndjen sepse të gjithë e njohim Bislimin që ka një vullnet që gjërat i thotë ashtu siç janë nuk mund mu lakua mi dhanë kaheje tjetër ndryshe qysh ju konvenon juve por këto janë fakte që qytetaret përballen çdo ditë me to elemente bazë të jetës ndaj nuk keni të drejtë ti a mohoni atë çka po donë me thanë se gjithë herë po ju përzini e nuk është e ndershme kjo por le ta shpreh ata që e mendon çka e ndjen dhe çka e përjeton e ju nëse keni kundër përgjigje jepni asnjëherë nuk ja kemi mohua ky është debat në kuvend debatet bëhen të tilla edhe kisha kërkuar që mos miu përzije se shumë herë po ju përzini , un sot do të ngris një kërkesë e cila ka të bëjë me interesin e qytetarëve të komunës së Vitisë besoj se nëse ju si qeverisje komunale merrni seriozisht me këtë kërkesë mund ta realizoni është një kërkesë e cila ka të bëjë me ndërtimin e një stacioni hidrometeorologjik në Viti meqë kuma e Vitisë është kryesisht rajon bujqësor dhe shpesh po goditemi nga moti i lig i cili po shkakton dëme të mëdha në bujqësi por edhe te qytetarët në përgjithësi se si lëvizje Vetëvendosje mendojmë që do të ishte me interes se komuna jonë të ketë një stacion të tillë që do të ndihmonte në vlershmin real të reshjeve të temperaturës në këtë regjion por të ndihmonte edhe në paralajmërimin e paraqitjes së motit të keq siç po ndodh shpesh shirave të rrufeshëm dhe breshrit, paralajmërimi i motit të keq do të ishte me interes për fermerët e komunës së Vitisë të cilët kur ta din se do të ndodh një gjë e tillë do të marrin edhe masa që ta kalon me sa ma pak dëme , tash nuk e di si është e mbrojtur me ligj por ne si komunë do të ishte me interes takëmi edhe sistemin mbrojtës nga breshëri sepse ne të gjithë e dim se kulturat perimore në fshatrat Skifteraj, Mugillë Kllokot po ashtu edhe pemët nëpër fshatrat tjera shumë herë po dëmtohen tërësisht nga breshri dhe po ju shkon munda huq këtë po me arsyetimin se nuk jam te shtrua si kërkesë vetëm për të dal dhe për të fol diçka, por po ju tregoj se këtë e kemi pasur të planifikuar edhe në alternativën tonë qeverisëse lokale dhe se për ta kemi pasur kontakte edhe me drejtorin e stacionit meteorologjik të Kosovës dhe ata kanë qen të interesuar ta kenë një pikë referuese të motit edhe nga ky regjion sepse Viti ka një klimë ma specifike një mikro klimë të veçantë dhe këtë sigurisht e keni vërejtur.

**z.Bekim Azizi:** Shqetësimi i Mirlindës për ujërat na e dimë që lumenjtë janë në menaxhim të ministrisë, mirëpo qyteti është në menaxhim të komunës, të suksesshëm jeni sa i përket vërshimeve të qytetit të Vitisë që bëhet po thaj që çdo reshje që vjen unë prapë kam një shqetësim ma të madh se Bislimi kur bisedon ndoshta ka arsye sepse shumë herë i ngrisim disa çështje, por nuk ktheni përgjigje seanca e 5 është që e kërkoj një arsye prej dy reshtave cila është arsyeja që u djeg drejtorja e bujqësisë edhe e shërbimeve publike ju e keni pru një proces që nuk cek asgjë , seanca e tretë është që e kërkoj ndihmat momenatle që i ka dhanë zyra e kryetarit të komunës nga subvencionet kuna i ka dhanë ndihma me emër me mbiemër edhe këtë nuk e keni prua është seanca e dytë qe e kërkoj listën e të punsuarëve me kontrata mbi vepër me na i sjell atë sa janë edhe këta nuk e keni prua . Një pyetje e kam për drejtorin e financave kur e dimë se mjetet e Zotuara për Kanalizimin e Smirës, Tërpezës edhe për projektet

e pa përfunduara për mjete që nuk janë pagua ato mjete janë bërë pagesë për punimet shtesë nëpër lokacione tjera me qfar vendimi ato mjete se janë zotuar për një projekt kush e ka marrë atë vendim se ridesitinimin e bënë kuvendi me qfar vendimi është pagua shembull punët shtesë në Verban a dikun tjetër e janë për projekte tjera që kanë mbet pa përfunduar pra me qfar vendimi bëhen të zotuarra për një projekt të paguhet një projekt tjetër , në fund e kisha pasur një kërkesë para dy vite është kanë një aksion i dy këshillave të përbashkët të fshatrave Smirës dhe i Gushicës për një bust të Mirali Sejdiut shkolla në Gushicë pasi e mban emrin mirëpo ka pasur një shqetësim te disa qytetar që nuk ju ka dok emri që është zyrtar mirëpo qe dy vite busti është gati un kisha pas kërkesë prej institucioneve dhe prej këshilltarëve të atij vendi pasi është 5 prilli afër me marrë një pëlqim edhe me ta pasi shkolla zyrtarisht e mban emrin që të bëhet një gurëthemel për mu vendos ai bust.

**znj.Besiana Rexhepi:** Unë do isha lidhur me sektorin e arsimit ku do bëja një përshkrim të gjendjes aktuale që gjendet ky sektor, është fjala për disa objekte ku një shembull e kemi te shkolla dëshmoret e Vitisë që sa kohë është në shkatërrim e sipër dhe nuk i bie ndërmend askujt që është i rrezikshëm për fëmijët e nxënësit është burim permanent i infeksionit aq ma keq se ky shërben si vend strehim i të rinjve për sjellje amorale, mirëpo do i bëja apel drejtorit të arsimit që ta bëjë një lloj inspektimi në tualetet e shkollave ku e dimë se në çdo shkollë si hynë në korridor kundërmon nga erërat e më tutje në shkollën e mesme hoxhë Januzi dhe në atë fillore Bafti Haxhiu nëpër klasa dhe sallë ngrihet pluhur dhe shumë mësimdhënës dhe nxënës lëngojnë nga alergjia prej pluhurit. Shkolla e re që ka nis ndërtimin ka sa vjet dhe nuk po bëhet e gatshme për fillimin e saj, gjithashtu do të kisha shprehë një lloj shqetësimi administrata ka shtuar masën për funksionimin e këtij sektori mirëpo ne si VV kërkojmë që të shtohen masa mbi këqyrjen e arkivës së kadastrit pastaj te çështja e infrastrukturës këtu nuk do të kisha folur për at qa është në kompetencë të ministrisë së arsimit po dhe atë lokale dhe rrugët e qytetit duke shikuar rrugët prej stacioni e deri te Vineksi do të shini edhe pasqyrën e rrugëve tjera veçanërisht të fshatrave e mos të flasim për fshatra ku nuk ka asfalt si p.sh.: rrugën e shkollës së Gushicës rrugën e vjetër që quhet nga banoret e fshatrave Remnik Nasal , Gjilani e ka shtruar pjesën e tyre me asfalt kurse komuna jonë nuk ka punuar ende asgjë rrethe kësaj dhe është e pa kalueshme .

**z.Sejdi Emini.** Bekim po lidhna me ty që the që është një bust i Mirali Sejdiut qe dy vite gati , Bekim ajo gjendje që ka ndodhur ka ndodh në qeverisjen e kaluar dhe nëse mënoni që mendoni se i keni bërë ashtu në bazë të ligjit edhe te respektua fshatin e Gushicës atëherë nuk është dashtë masë dy viteve me kërkua është dashtë atëherë kur e keni pasur pushtetin ju , Bekim e din edhe ti ma mirë se na se kjo është ardhur pa dëshirën tonë në atë pozitë na ka pru pushteti i kaluar nuk u kanë pozitë e mirë që na ka pru se na ka pru me një pozitë të palakueshme, sepse nuk është përfaqësuar vullneti i qytetarëve të Gushicës dhe ti e din qysh janë ato rregulla dhe e din qysh duhet mu kanë , ndoshta në luftën e fundit në Gushicë nuk ka pasur asnjë të vlarë po ma herët janë mbi 52 të vlarë dhe atë në Gushicë shumë e njeri u rritë jetim un mendoj se duhet mi respektua edhe ato vijat e më hershme sepse kemi ardhur këtu tu bë vija të gata nuk jemi nisë para 10 viteve edhe kemi ardhur këtu jemi nisur me shekuj prandaj nuk u kanë e mirë me pru në qatë formë qysh e keni pru edhe un jam për me dal prej kësaj gjendje mirëpo ti respektua të gjithë

**z.Samet Idrizi:** I nderuar Sejd, Bekimi veç kërkoj me zgjidhë problemin tash ndoshta ky nuk është pjesë e atij problemi un mendoj ashtu ai nuk kërkoj diçka të jashtëzakonshme ke shumë i

arsyeshëm, kamë disa kërkesa të qytetarëve të cilët ankohen janë punë të vogla dhe nuk kishin me kushtua shumë dhe nuk kishin me ndikua në buxhetin e komunës e keni parë edhe vetë nxënësit e shkollës së mesme lëshohen prej mësimi ata për me kalua aty duhet mi ndal veturat dhe un kërkoj prej komunës që të krijohet një komision edhe aty para lindit të bëhet një shpronësim që të bëhet një tretuar prej resturant “Lindi” e deri te shkolla mesme në mënyrë që nxënësit të hecin nëpër tretuar jo rrugës, edhe trotuari prej selisë së partive aty ka mbetur në gjysmë e deri te Xhamia poshtë edhe këtu duhet të intervenohet edhe kjo nuk është kosto e lartë, objekti i ndërtuar për raste sociale aty rruga është nënstop me baltë dhe e zhytë rrugën edhe aty duhet me intervenua edhe ka një prangosje të fshatit Debëllde ata ankohen se nuk kanë komunikim të këshilltarëve të PDK-së kërkon nga qeveria lokale të i respektoj udhëzimet në fuqi në mënyrë që të jetë më efikase në administrimin e pushtetit që e ka tu nisë prej ligjit të punësimin në administratë në arsim po ashtu ligjet në fuqi të prokurimit të respektohen në mënyrë që të ketë transparencë ma të madhe për operatorët ekonomik dhe qëllimi e krejt kësaj është të jemi ma efikas në punën tonë që e bëjmë.

**z.Daut Xhemajli:** Unë kamë vërejtje se kjo pjesë po shndërrohet në diskutime a kjo pjesë është për pyetje edhe përgjigje ose propozime në mënyrë që të bisedojmë në pikat të rendit të ditës për seanca tjera se për çfarëdo çështje një po diskuton tjerët po dëgjojnë edhe nuk po shtrohet si pikë e rendit të ditës , un mendoj se duhet me propozime nëse janë të arsyeshme me një arsytim të shkurtër edhe duhet të gjendet kohë që mu shtrua si pika a kështu nuk mendoj se është mirë me marrë kohë un e kamë një propozim edhe një kërkesë , propozimi është pak i rënd për komunën dhe për mua që po e thamë por mendoj se është koha kur duhet me diskutua në fillim u falënderuam për manifestimin e “Flakadanit të Karadakut”, unë mendoj dhe propozoj që kuvendi edhe institucionet duhen të merren me riprogramimin e këtij manifestimi, çka duhet përfshi ajo duhet të jetë temë e diskutimit kur ta debatojmë si çështje bashkë me gjithë akterët që të përfshihen të gjithë të rënë të shkurtohet se Vitia nuk ka kapacitet me e përballua një javë aktivitet por megjithatë un jam që të shtrohet si pikë edhe të diskutohet edhe të rrumbullakohet në mënyrë që edhe karakteri edhe masiviteti edhe respekti të jetë ma i madh edhe ma gjithë përfshirës, një kërkesë e kamë që në mbledhjen e radhës të jetë pikë e veçan edhe të mos diskutojmë përherë për çështjen e pastrimit të lumenjve të bëhet debat ku i kemi mundësitë ku i kemi buxhetin ku i kemi projektet edhe qysh mundemi me dal prej kësaj gjendje nuk ka asnjë pushtet lokal që mund me zgjidhë këtë problem afat shkurtër.

**Kryesuesi:** Unë vazhdimisht kamë tërheqë vërejtjen që mos të debatojmë në pyetjet dhe kërkesat që i kemi po na ana e këshilltarëve po insistohet dhe un mendoj se nuk është në rregull , nënkryetar po besoj se u parashtruan shumë pyetje prandaj fjala është për ju para se ta merr fjalën nënkryetari urdhëro Baki

**z.Baki Nebihu:** Unë e kam një pyetje drejtuar kryetarit por pasi nuk qenka është nënkryetari para disa muajve është instalua ndriçimi i rrugës kryesore për me muaj të tërë ato nuk janë funksionale banorët e fshatit kërkojnë me ditë se ku është problemi që nuk funksionojnë dritat e instaluara nga vetë ju.

**z.Hasan Aliu:** I nderuari kryesues në radhë të parë tut përshëndet edhe një kritikë shumë të madhe për ndoshta tejkalimin e të gjitha suazave normale e punimeve të një kuvendi dhe nuk kisha dëshirua me pa këtë gjendje të vetë këshilltarëve të përgatitjen e referateve të ndryshme pa u përmbajt në pika të rendit të ditës kur ne pak ma parë e kemi përfundua “Flakadanin e Karadakut” edhe e kemi pasur orën letrare keni mund me garua dhe kish marrë shpërblime për

ato i kishin nda fletat e jo bashkërisht ti e nderuara mësuese me Bislimin ma mirë është mi nda në shpi se këtu tani po ju përzihen prandaj nuk na hupni shumë kohë dhe un e di se ju jeni ata me ngritjen e dorës e keni aprovuar rregulloren e punës dhe nuk ka ma keqe për këshilltarët komunal për një rregullore të cilën ju e keni aprovua dhe ju jeni shkelës të kësaj rregullore prandaj nuk kisha dëshirua me ju pa në një gjendje të tillë . Un po fillojë prej Mirlindës më vjen shumë keq e nderuara profesorësh të gjitha ato kërkesa që ti i ke shtrua i ka të evidentuara pushteti lokal por megjithatë të kisha dëshirua ti je aprovuese e buxhetit komunal tu kisha lutë të sillësh në kuadër të kësaj merrne nganjëherë dhe shikoni mundësitë e Vitisë sa ka të gjitha ato kërkesa që ju sot i shtruat buxhetin e Kosovës me na i dhanë është problem mu rregullua prandaj silluni në kuadër të mundësive buxhetore që i ka komuna e Vitisë e jo në kuadër të fontanë dëshirave andaj duhet të jeni të përgjegjshme për ato të cilat i bëni ju e dini kur se di sa herë kryetari i komunës z. Sokol Haliti së bashku me drejtorin e financave e kanë shprehur gjendjen e një buxheti i cili ka qenë i aprovuar që nuk ka qenë në përputhje me projektet të cilat janë realizua në vitin 2014 në mesin e tyre ka qenë edhe çështja Navosellës , ka pasur aq pare pak në lidhje me projektin edhe në mungesë të sajë nuk është ndërtua ajo gropë septike dhe sivjet na jemi tu merr me Fshatin e Ri biem edhe me shpronësimin e tokës që është problem i trashëguar nga ish qeveria të njëjtën kohë ta rregullojmë edhe çështjen e Ramjanit edhe çështjen e Fshatit të Ri, nuk dua të merrem me lumin edhe me vërshimet që i kemi pasur se mjerisht prej 27 këshilltarëve prej ditës së shtunë e deri sot asnjë se kam parë që jeni dal mi qajtë hallet me qytetarë dhe prandaj ata të cilët e kanë ndie dhe kanë qenë edhe në kujdestari deri sot në mëngjese pa ndërpre dhe në mesin e tyre ka qen edhe kryetari i komunës së bashku me drejtorin që vlen me falënderua edhe shërbimin e zjarrfikësve edhe kryqin e kuq edhe higjienën të gjithë kanë qen të mobilizuar që ajo që ka mundësi mu evitua të evitohet atë të cilët nuk ka mundësi edhe ato ndodhin vërshimet ndodhin nëpër krejt botën, sa i përket “Flakadanit të Karadakut” të shtrohet çështja e riprogramimit pse mos të shtrohet kur është në të mirën e komunës sonë dhe në të mirën e qytetarëve tonë një informacion e kam obligim Daut me ta dhanë nga viti 2013 nga 23 mijë ero të harxhuara për “Flakadanin e Karadakut” vitin e kaluar është kanë 15 mijë euro ndërsa sivjet duhet të jetë diku rreth 11 mijë euro. Unë ju kisha lut që të ju përmbahemi rregullores sepse në këtë rast ju vetë po e shkelni ligjin pasi nuk po ju përmbaheni rregullores prandaj nuk e ka të arsyeshme këtë dhe krejt në fund shoqatat e dalura nga lufta dhe shoqatat tjera që veprojnë në komunën e Vitisë kanë qenë kanë qenë në zyrën e kryetarit të komunës dhe ju njoftoj se është një iniciativë e tyre që ja kemi miratuar edhe ne që të organizohet përvjetori i demonstratave të vitit 1981 që në Viti kanë qenë me 3 prill prandaj na zakonisht kemi bërë homazhe se e kemi një të ramë nga ai vit i protestave është Sherif Frangu nga Sllatina e Poshtme , dhe sipas të gjithave gjasave do të ketë edhe një tribunë të cilët të gjitha që janë të interesuar mund të paraqiten me komtesat e tyre kjo do të ndodh me 3 prill për orën mund të

**Kryesuesi:** Keni nga një minutë për replikë urdhëro:

**znj. Mirlinda Sadiku:** I nderuari nënkryetar nuk është fontan dëshirash këto ankesa më kanë ardhur prej qytetarëve njerëzve që kanë obligim edhe moral edhe politik d.m.th kjo është çështja se këtu ju ka bë dom njeriut deri në 2 mijë euro dhe mund ta them me emër është nga Pozherani, edhe Skifteraj në atë kohë ka qenë ka qenë në pushtet LDK-ja projekti ka kushtuar 450 mijë euro ka qenë me participim të qytetarëve, mirëpo komisioni evropian edhe ka dhanë shumicën e parave në Ramjan, atëherë pse nuk e keni lanë këtë projekt deri sa ti gjani paratë

tjera edhe ta bëni projektin taman sikur që duhet deri në fund euro një herë me bë kështu e mi ndot kështu arat, dhe ajo nuk që nderon se the gjatë vërshimeve se u kam dal në Gjylekar, Ramjan, Pozheran dhe në Kllokot dhe e kam vëzhguar gjendjen nga afër.

**z.Bekim Azizi:** Kryesues kur të kërkojmë fjalën për replikë është mirë me na i dhanë dhe se këtu jemi në kuvend të gjithë ardhur me votë i vetmi ti nënkryetar këtu je i ardhur pa votë pra je me emërim dhe po fol me një formë që po i injoron të gjithë këta qa po bisedojnë nuk e kemi krejt keqe po apsolut nuk ta krahasova kanalizimin vetëm thash në bazë të qkakit i ke bart mjetet e zotuar për këtë kanalizim i ke bart qetu pra e ke pagua kanalizim në Vorbanë un spo kërkoj kurgja ma shumë kaqë , qe 5 seanca e kamë lyp këtë nuk e ke pru qe tri seanca i kam kërkuar qeto ti thua bënë kërkesë pas dy dite i merr thjesht bjeri qeto shënimetë shohim qa janë se po e shohim se nuk është diqka në rregull un apsolut kurgja nuk ta lidha na vetim po i kërkojmë kush janë në listë që i paguani nga shërbimet e veqanta , sa i përket Gushicës është zyrtare emri un vetëm kërkoja mu rrespektua dëshmorë sepse emri është zyrtar vula është zyrtare dëftesën e merr me emër të shkollës vetëm kërkoja me bë zgjidhje për këtë.

**z.Ali Bajrami:** Vetëm për hir të njoftimit të qytetarëve, se Gushica e dinë kur u bë propozim ndryshimi emri ka qenë Zenel Hajdini, katër shkolla kanë qenë me qatë emër propozim vendimi që ka ardhur në drejtori të arsimit këshilli shkollës e ka qua me mandat të skaduar pra nënshkrimi që ka ardhur prej këshilli të fshatit Gushicë ka qenë pa pëlqimin e Gushicasëve ajo pse u bë ka qenë një premtim elektoral nuk jemi kundër dëshmorëve nuk jemi kundër UQK – së vetëm një gjë po ta themë se Gushica ka njerzë dhe i dalin zot Gushicës prandaj proceduralisht është bërë shkelje edhe është shumë e dhimbshme që shkolla e Gushicës një prej shkollave ma të vjetra me emër të Zenel Hajdini nomiklaturen e re është prapë emri tije prapë emër i dëshmorëve është bërë një shkputje që nuk i bënë nder askujt

**Kryesuesi:** Për këtë seancë kemi paraparë këtë:

## **Rend dite**

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dytë e KPF-së të Vitisë.**
- 2. Propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër pronat e paluajtshme të komunës Kompanisë KKDFE sha “KEDS” J.S.C, për vendosjen e trafave elektrike.**
- 3. Propozim vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Mbrojtjen e Mjedisit të Komunës së Vitisë.**
- 4. Propozim vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit 01-013/250, të datës 02.03.2015.**
- 5. Propozim vendim për ndarjen e mjeteve financiare për rregullimin e varrezave të veprimtarëve të çështjes kombëtare Halil dhe Teuta Alidema.**
- 6. Draft plani për përmbushjen e transparencës në Komunën e Vitisë.**

A ka dikush rrethe rendit të ditës, nëse nuk ka e hedhim në votim për miratim, me vota unanime u miratua rendi i ditës.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi:

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dytë e KPF-së të Vitisë**



Hapim debat, a donë dikush ta merre fjalën?

**znj. Majlinda Ostroglava:** Përshëndetje, videja gjatë fjalimit tim në youtube dhe në televizion është shkëputur minutat e fundit kështu që nuk është bërë me një qëllim të keq, por vetëm po e jap si vërejtje për herëve të tjera.

**Kryesuesi:** Po të siguroj që nuk ka diçka, se është bërë me qëllim a ka dikush tjetër nëse nuk ka e hedhim në votim, me vota unanime miratohet pika e par e rendit të ditës.

Si pikë të ditë të dytë kemi, e kamë një lutje, pasi drejtori i Financave ka një takim dhe më është lutë që këtë pikë ta qesim më herët, a jeni që të ndërrohet dhe të dal më herët me ngritje dore, faleminderit, atëherë si pikë të dytë të rendit të ditës kemi:

## **2. (4) Propozim vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit 01-013/250 të datës 02.03.2015.**

Ftoj drejtorin e drejtorisë përkatëse ta merre fjalën

**z.Ibrahim Rama:** Përshëndetje të nderuar anëtar ju të gjithë të pranishëm! Të njëjtin propozim vendim me ndryshime e kemi marr në mbledhjen e kaluar dhe kjo është aprovuar në kuvend, vlera në total është e njëjtë 212 mijë e 901. 99, por që kur kemi vendos herën e kaluar këto të hyra vetanake këto janë kryesisht të hyrat vetanake se janë grumbulluara në vitin 2014 dhe ne kemi paraparë që një pjesë të tyre për arsim dhe shkencë e kina definua mi bartur 18365 euro, ndërkohë kur e kemi qua vendimin në Ministrinë e Financave na është thënë deficivisht mjetet që bartën nga viti 2014 në vitin 2015 të transmetohen në të gjitha pozicionet programet apo nën programet që janë paraparë me buxhet të vitit 2014. Pasi keni marr materialin me kohë jam i gatshëm tu përgjigjem nëse keni diçka.

**Kryesuesi:** Hapim debat rrethe kësaj pike:

**znj.Mirlinda Sadiku:** Megjithatë ju na thatë drejtor se nuk ka thyerje ligjore, u do të isha kthye mbrapa në seancën e mbajtur me 31.03 .2014 ku y. Ekrem Abazi kishte propozuar se nga shuma e mbetur e vitit 2013 e citoj pra në vler prej 84 mijë ero propozoj që 50 % e kësaj shume të shkojë në shëndetësi dhe mirëqenie sociale ndihma momentale për njerëzit se kanë shumë nevojë, z. Bislim Bislimaj ka thanë se këto pare tu jepen rasteve sociale dhe për rini, kulturë dhe sport e sidomos te subvencionohet bujqësia, ndërsa fjalët e ta janë buxheti nga të hyrat vetanake nga viti 2013 duhet të barten saktësisht aty ku e kanë pasur destinimin dhe ne nuk kemi të drejtë dhe nuk guxojmë me ndryshua asgjë ndërsa propozimet e disa këshilltarëve këtu mund të bëhen vetëm me ridestinim të buxhetit ndërsa këto nuk guxojnë të ndryshohen, mu më intereson na ke thënë edhe atë ditë në KPF se nuk është në kundërshtim me ligjin, mirëpo kur kemi bërë bartjen e mjeteve prej vitit 2013 në vitin 2014 këto janë fjalët që na i ke thanë, dhe pyetja dytë është si ka mundësi brenda 2 jave tu ndërrohet destinimi i këtyre parave, sepse e shohë këtu se për shëndetësi dhe mirëqenje sociale vetëm 457 ero e potencoj edhe atë që e tha edhe z. Bislimi un vet kam qenë e sëmurë dhe nuk ka pas as kanila as infuzion as kurgja d.m.th kanë munguar lista e barërave esenciale , ndërsa sa i përket arsimit të jesh i bindur se gjithherë po thuhet qeverisja e kaluar por në qeverinë e re po e marrë shembull shkollën tonë teknike ku gjysma e mësimdhënëseve janë të sëmurë nga pluhuri dhe nga pa pastërtia aty dhe nuk kemi ngrit qaq pluhur me bindjen se po dalim në shkollën e re ai i aty nuk funksionon sidomos printi i asaj shkolle nuk funksionon na asnjë plan program s'mund ta printojmë sepse ja

na i qet zi ja na pështjellohet aty, d.m.th nuk është funksional, qeto pare që i keni nda për shërbime dhe mallra është mirë mi nda për arsim.

**z.Bekim Azizi:** Nëse nuk ka shkelje atëherë në momentin se e ka kthye ministria atëherë ti nuk ke dit me bë këtë, asnjë propozim nuk e dhamë se krejt e kemi ditë se këto mjete me cent duhet me shkua në kode buxhetore ku kanë tepruar ve drejtori nuk e paska ditë edhe i ka marrë në arsim , na e dimë se n arsim vynë se është bërë një ngarkesë e madhe mirëpo na e dimë shumë mirë se edhe vitin e kaluar kur e kemi bërë bartjen e në Kpf që kemi bërë kërkesa absolut i këna mbyll debatet të gjitha sepse këto mjete nuk ka mundësi mu ndërrua kodi ju e keni ndërrua kodin ja ka kthye ministria d.m.th këtu është problemi ose mungesë e dijës sepse nuk dinë me bë ose e kanë bërë me qëllim .

**z.Ibrahim Rama:** Po u garantoj se këtu nuk ka thyerje ligjore të këtij vendimi dhe të gjithë ata se pretendojnë që ka diçka sekret ose un nuk e di ata janë në lajthim personal, unë prapë po ju them personalisht mbaj përgjegjësi nëse është bërë thyerje e ligjit, nuk e kemi kaluar askund planin që është i paraparë për vitin 2014, se atëherë është thyerje ligjore këtë veprim që e kemi marrë në vendimin e parë e kemi marrë në bashkëpunim dhe me mirëkuptim me drejtorin për buxhet komunal.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor për këto sqarime pasi nuk kemi të lajmëruar për diskutim e hedhim në votim për miratim, me 12 vota për 5 abstenime dhe 1 kundër miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

**3. (2) Propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër pronat e paluajtshme të komunës Kompanisë KKDFE sha “KEDS” J.S.C, për vendosjen e trafove elektrike.**

Ftoj drejtoreshën e gjeodezisë që ta merre fjalën.

**znj.Fatbardha Emini:** Unë sot para jush paraqes propozim vendimin e cekur ma lart që i jepet kompanisë për shfrytëzim afatshkurtër prej 15 viteve parcelat me nr. 12,11, me sipërfaqe prej 6 metra katror, parcela 12,21, fran 2, me sipërfaqe 6 m<sup>2</sup>, të cilat gjinden në zonën katastrale të Gërmoves, parcelat me nr. 49, fran 2, me sipërfaqe 6 m<sup>2</sup> dhe parcela 792, fran 2, me sip. 4m<sup>2</sup> të cilat gjinden në zonën kadastrale të Gjylekarit dhe parcelat me nr. 985, fran 3, me sip. prej 9m<sup>2</sup> në zonën kadastrale të Pozheranit dhe parcela me nr.2507, fran 3, me sipërfaqe 12 m<sup>2</sup> në zonën katastrale në Viti. Me datë 23.02.15 në drejtorin tonë ka ardhur kërkesa nga kompania e lart cekur për tu a caktuar vendin për vendosjen e 6 travave elektrike, ne kemi pruar këtë propozim vendim të bashkangjitura kini edhe kopjet për pyetje janë apo sugjerime jam në dispozicion për tu ndihmuar.

**Kryesuesi:** Meqenëse sot kemi mysafirë ministrin e ambientit, atëherë besoj se kemi mirëkuptim për një pjesë të drejtorëve se shkuan në takim atje, ndërsa hapim debat rrethe kësaj pike të rendit të ditës.

**z.Sami Demelezi:** Konsideroj se propozim vendimi që paraqiti drejtoresha para nesh është konformë një kërkesë nga kompania KKDFE sha KEDS Viti dhe meqë ka të bëjë për lokalitete Viti , Germovë , Pozheran , Gjylekarë dhe është pjesë e infrastrukturës për nevoja të qytetarëve tanë un jamë pro së bashku me grupin parlamentar të Ldk-së dhe meqë kompania është private duhet të rrespektohen striktë rregullorja për pagesa që është miratua nga ne .

**z.Sejdi Emini:** Ne në parim e përkrahim çdo përmirësim të kushteve energjetike në komunën tonë mirëpo gjithnjë duke i respektuar dokumentet zyrtare të cilat i kemi nxjerrë pikërisht nga ky kuvend , ma herët para disa seancave ne ke rënë para një akti të kryer kur ju kuvendin e keni prua me një pozitë pikërisht për kedsin edhe se të gjithë e dimë se është kompani fitimprurëse private për parcelat në Kabash dhe Smirë të gjithë ju e keni ditë që në ato parcelat veçë ndërtimi kishte filluar edhe puna gati ish kanë përfundua dhe ju e keni prua këtu në kuvend një dokument që a po ja japim apo nuk po ja japim , ju kisha lutë që të jeni konformë ligjit mos na bini në pozita të pa lakmueshme as ne as vetën sepse nuk është edhe e ndershme , krahas kësaj kërkesa ka qenë dashtë ta kemi edhe një dokument zyrtar nga drejtoria përkatëse sepse ta dimë a është konformë planit zhvillimor urban komunal .

**z.Samet Idrizi:** Atëherë ky është vetëm një propozim vendim, është mirë të shihen pronat në mënyrë të saktë në mënyrë që mos të përsëriten disa gjëra i cekën ma herët prona është komunale, dhe unë mendoj se kjo ma tepër është inicim i këtij propozim vendimi që duhet të kalojë në të gjitha fazat aty te komisioni që merret me këto punë dhe respektimi i rregullores mbi caktimin e çmimit etj.

**z.Hasan Aliu:** Mu duk e arsyeshme nëse ndalimi atë se e thotë Sejda plotësisht është në qatë formë por Sejd për me qenë shumë i sigurtë veç duhet me thanë deri në fund se na jena ballafaquar me dy trafo të ndërtuara kur jemi ardhur si qeveri komunale dhe këtë ta thoshe u kompletojke dhe dy kërkesa të cilat ju kanë drejtua në kohë ata të KEDS-it dhe kurrë nuk kanë marrë përgjigje dhe në momentin e ardhjes si qeveri komunale që ashtu e kemi thanë edhe para jush nuk kemi fshehur kurrëgjë i kemi gjetë dy trafo të cilat kanë qenë të instaluar por që përgjigje kurrë nuk ju kanë kthyer dhe prandaj ne nuk kemi dashtë me anashkaluar kuvendin e kemi thënë shumë arsyeshëm. Unë e arsyetova në arsyeshmërnë për shkak se drejtoresha lidhur me ato dy trafo nuk ka qenë në atë kohë në ushtrim të funksionit të drejtoreshës dhe për pjesën tjetër e kemi drejtoreshën .

**z.Sejdi Emini:** Nën kryetar ti mirë po e thua, por edhe ti veç duhesh me thanë edhe këtë pjesën tjetër se KEDS-i veç se i ka ndërtua ato trafo se asnjë delegatë nuk e ka ditë deri sa e kemi përmendë ne, të lutem banu transparent edhe ju tregone realitetin, atëherë flasim me një qasje drejtë.

**Kryesuesi:** Pasi u dha një arsytim nga nënkryetari, e hedhim në votim për miratim, me 17 vota pro dhe 4 abstenime miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të katërt kemi:

#### **4. (3) Propozim vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Mbrojtjen e Mjedisit të Komunës së Vitisë.**

Po ju informoj se kjo rregullore ka ardhur me lexim të parë këtu në kuvend dhe sigurisht do të del me 16 prill do të del në debat publik dhe formën finale do ta merre në seancën e radhës, e cila do të mbahet sigurisht muajin tjetër, por sidoqoftë ja japim fjalën drejtorit.

**z.Ajet Sallahu:** Ky ndryshim i rregullores ka ardhur si pasojë për shkak të nevojës për harmonizimin me rregulloren udhëzimit administrativ 10. 2012 dhe 18 .6. 2012, do me thanë që ne rregulloren e mëparshme nuk kemi pasur të parapamë leje mjedisore komunale që udhëzimi administrativ e sheh si dhe ndryshimi e disa gjobave, që i parasheh ky udhëzim

administrativ, unë nuk po hi në detale sepse i keni para materialin, prandaj nëse ka dikush diçka jam i gatshëm të jap kontributin tim.

**Kryesuesi.** Hapim debat rrethë kësaj pike.

**znj. Mirlinda Sadiku:** Drejtor u bë një lëshim teknik ndoshta këtu i keni ndryshimet që janë bërë për leje mjedisore komunale nuk është neni 31 por neni 32 po ashtu materiali që na u ka afrua në fletën e fundit e ke shllan neni 52 serbisht e ki le të evitohet ajo megjithatë sa i përket mjedisit jam për mu respektua mjedisi edhe sinqerisht janë momentet e fundit se duhet mu kujdes se çfarë mjedisi të tu lamë trashëgimi nipave dhe mesave do ti kisha dhënë disa sugjerime, këtu nuk i ke të gjitha fshatrat në menaxhim të mbeturinave si do të implementohet kjo rregullore , e ki te neni 5 p.sh.: për mirëmbajtjen e parkingjeve tregut sipërfaqeve gjelbëruese, varrezat, shtratin e lumit “Morava” këtu duhet të korrigohet sepse ju nuk jeni përgjegjës për krejt shtratin e lumit “Morava”, sepse ajo do të ishte shumë mirë për ju jeni vetëm për pjesën ku kalon nëpër qytet këtu nuk është theksuar pastaj te neni 6 këshillat banesore dhe ato të lagjeve janë përgjegjëse për mirëmbajtjen edhe pastrimin e hapësirave për rreth banesave si do të veprohet tek ndërtesa e verdhë ku e dimë se në çfarë gjendje është qeft podrumi qoftë ambienti përreth ku e dimë se banesa verdhë është ende në menaxhim të habitatit si do të veproni këtu , te neni 7 të gjitha ndërmarrjet hoteliere mishtore blegtove dhe personat fizik obligohet se eshtrat e kafshëve të therura ti vendosin në kontejner të caktuar çka nënkupton kjo, te neni 13 ne perime jemi lider në përpilimin e rregulloreve po ashtu edhe ligjeve në nivel të Kosovës po kur vjen puna me implementua është problematikë shumë e madhe ,

Ndërmarrja është e obliguar në periudhën prej tre muajsh ti dezinfektoj kontinjeret kjo kurrë nuk ka ndodhë, masë ne kemi te menaxhimi i mbeturinave medicinale ndoshta doktoreshat mund me korrigjua se nuk është fushë e imja po këtu thotë se ndalohet hedhja e mbeturinave medicinale në kontijerë dhe këtu parashihet dënimi për ordinancat private mirëpo nuk parashihet se si do tu afrohet alternativa se nëse e ndëshkon , tash kemi nenin 23 për çudi tash bie ndesh me ato dy qashtje që i ngrita në fillim të seancës ku thotë obligohet qdo rrjet i kanalizimit publik për ujërat e zeza nëpër fshatra që në përfundim të rrjetit të ndërtojnë gropa septike qa me bë me ato fshatra që nuk ka gropa septike qka me bë me ata qytetar që nuk janë të kyçur në rrjetin e kanalizimit pa dëshirën e tyre , po ashtu edhe neni 24 e parasheh ndalimin e ujrave të zeza në sip. Publike pak a shumë këto ishin vrejttjet po ashtu kemi edhe mbrojtjen nga zhurma te neni 39 , te neni 43 se në kompetencën e drejtorisë së shëndetësisë policisë Kosovës drejtorisë për shërbime publike drejtoria për inspeksion vjen ky nenë do të ishte mirë të bashkëpunojnë me Drejtorinë e Bujqësisë sepse është e vërtet që malet se janë djegur të zëvendësohen me fidanë të reja të ripërtërihen ato male sepse ajo është pasuri kombëtare te e fundit janë të mbrojtura edhe me kushtetutën e republikës së Kosovës.

**z.Samet Idrizi:** Meqë është vetëm si propozim vendim te pa edhe rendësin e kësaj rregullore kur dihet se mjedisin e kemi ma së keqi grupi i këshilltarëve të PDK-së para se me ardhur këtu në kuvend si si vendim për miratim do ti dërgoj me shkrim sugjerimet tona.

**z.Sami Demelezi:** Kemi dy propozim vendime për ndryshimin e një rregullore disi jo bash e pëlqyeshme drejtor por gabimet janë të mundshme megjithatë kur është fjala te propozim vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e kësaj rregullore kam një vlerësim shumë pozitiv kam bindjen se shumë pak mbetet të ndryshohet edhe pas debatit sepse bindja ime është se është

punuar me mjaft përkushtim me shkua veç e veç nëpër nene le të mbetet pas debatit publik se do të thotë në periudhën e matutjeshme ne si grup parlamentar do të japim kontributin tonë.

**z.Bislim Bislimaj:** Pasi siç e than se është propozim vendim për ndryshim ne nuk kemi shumë qka të vendosim këtu por un veç i kisha dhanë disa udhëzime se ai debat që do të mbahet me 16 prill të jetë sa ma i suksesshëm dhe ata që e organizojnë këtë debat të jenë të përgatitur së paku me njohjen e ligjeve bazike me njohjen e mbrojtjes së ambientit, unë nja 3 vite kam punua në këto ligje kam punuar me një zyre ku janë dhënë politikat mjedisore dhe e di se shumë shpesh na ka ndodh që ligji me ligj ka has në kundërthënie e nuk po kam qefë me ndikua kjo saktësisht kisha pas dëshirë të dihen se qka janë kompetencat e komunës dhe çka janë kompetencat e ministrisë që mos të biem ndesh me ligjin , prandaj i ftoj edhe qytetarët të jenë aktiv në këtë pikëpamje sepse problemet fotografit që i ka bërë. znj.Mirlind me të vërtet janë trishtuese këto na hakmerren neve , organizmi i vetëdijshëm mi bërë këto shkatërrime me vetëdije dhe mu lan gjeneratave te reja këto dëme të pa riparueshme është e pa besueshme, por prapë po duhet në mënyrë kulturore mi pranua këto.

**z.Daut Xhemajli:** Unë te ky propozim rregullore te pasur parasysh se do të jetë në diskutim po në fillim ndoshta e kam një propozim për drejtorin që kjo të kategorizohet apo të ndahet kufiri mes asaj se inspektori komunal ka dënim mandatorë edhe kur të kalon prej asaj dmth lënda është qështje gjykatës në këtë aspekt janë të përzime un mendoj ish mirë mu nda de mia letua inspektorit komunal deri në cilin kufi ka drejt me shqiptua dënime mandatorë dhe nëse shkelja është ma e madhe atëherë lënda duhet të përcillet në gjykatë dhe inspektori mos të ngarkohet me atë qështje .

**z.Skender Ahmeti:** Nuk dashta me dal po Dauti e preki pak qështjen e Drejtorisë së Inspeksionit, konformë Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit inspektori mjedisor i komunës i ka të precizuar shumë qartë gjobat mandatorë dhe tash gjobat mandatorë nuk shkojnë për ekzekutim në gjykatë, por shkojnë te përmbaruesi privat edhe për fate të mirë veç kemi fillua edhe i kemi implementue me përmbaruesin në Gjilan dhe të gjitha dënimet që janë në atë rregullore jemi ti implementua.

**Kryesuesi:** Po konsideroj se nuk ka diskutime të tjera, atëherë prezent janë 19 këshilltar komunal, e hedhim në votim që të shkoj për debat publik kjo pikë e rendit të ditës, konstatoj se me vota unanime shkon kjo pikë për debat publik.

Si pikë të pestë kemi:

#### **5. Propozim vendim për ndarjen e mjeteve financiare për rregullimin e varrezave të veprimtarëve të qështjes kombëtare Halil dhe Teuta Alidema.**

Unë po ju informoj fillimisht se me familjaret e Halil Alidemës jam konsultua rrethë këtij propozim vendimi dhe kamë marrë mendimin e tyre, vitin e kaluar si institucione komunale kemi qenë për përvjetorin e vdekjes së Halilit në varrezat e sharrës në Tiranë dhe kemi konstatuar se varrezat janë në gjendje jo të mirë dhe vullneti i kryetarit dhe institucioneve komunale ka qenë që të bëjë diçka në këtë drejtim sepse me fol për qështjen e Halil Alidemes un konsideroj se të gjithë jeni në dijeni prandaj ndoshta e kisha ftuar edhe nënkryetarin që ta merr fjalën rreth këtij propozimi që ta jep arsyeshmërin.

**z.Hasan Aliu:** Unë nuk do të ndalem shumë se veç kryesuesi e cekti se hapi parë rreth kësaj ka qenë vitin e kaluar ku në mënyrë institucionale është organizua vizita që ka pasur një

delegacion edhe nga komuna dhe qytetarët dhe familjarët e të Pozheranit e kemi parë së bashku me kryesuesin se me të vërtetë figura e Halil Alidemës dhe e bashkëshortes së tij meritojnë një tretman ma ndryshe dhe ishte një iniciativë që i propozuam Kryetarit të Komunës të cilën e mirëpriti dhe u dakurduam që një propozim vendim ta bëjmë gjithherë me kordimin me familjaret që të na lejohet rregullimi i dy varreve , sa i përket jetës dhe veprës së tij nuk ka nevojë të flitet dihet se ai ka qen një veprimtar i madh dhe një sportist i dalluar nuk do ta zgjas ma shumë nëse ka dikush ndonjë pyetje.

**Kryesuesi:** Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës.

**Znj. Mirlinda Sadiku:** Ky njeri me të vërtetë është meritore për atë që kam kuptuar nga njerëzit që kam pyetur, vet fakti se një institucion shkollor mban emrin e tij i bënë nder për ta dhe është ide shumë e qëlluar dhe ne në KPF të gjithë e kemi përkrahur unanimisht, por vetëm na ka interesuar me ditë shumë sa është si projekt.

**z.Hasan Aliu:** Ne sot po bisedojmë për mendimin a na lejohet mi bërë hapat e mëtutjeshëm dhe me siguri se më vonë do të jeni të informuar edhe për çmimin , ne së shpejti do ta bëjmë një vizitë dhe do ta marrim një profaktur se sa kushtojnë dhe me siguri do të ju njoftojmë edhe për çmimin.

**z.Bislim Bislimaj:** Ne vërtet e kemi obligim edhe moral edhe historik për çdo njeri që ka bërë shumë sidomos të anës tonë ne i kemi respektua dhe i kemi nderua atë që kam mundur te rasti i këtyre personave apo njerëzve veprimtar që kanë vdekur në kohën kur kanë qenë në ekzil un ma shumë kisha dashtë me diskutuar me neve a kishte qenë ma mirë sikur mi tërheq dhe mi prua mi varros këtu me nderime si ju ka hije.

**Kryesuesi:** U kam diskutuar për këtë me familjen nuk na kanë dhanë ndonjë arsyetim për bartjen e eshrave , ne dimë se nuk ka qenë dëshira e Halilit të varroset atje, por ai ka vdekur në kohë lufte dhe si familje ma kanë dhënë pëlqimin për rregullimin e varrit atje.

**znj. Mirlinda Sadiku:** Ja formulimi nuk është në rregull apo nuk jam juriste, por këtu po thotë propozim vendim për ndarjen e mjeteve financiare kërkush nuk po e konteston atë dhe ndoshta kjo është një shumë e vogël qe bëjmë ne për të.

**z.Bekim Azizi:** Tu pas parasysh kontributin e veprimtarëve tash në këtë radhë Halil dhe Teuta Alidema grupi i PDK-së e përkrahë këtë vendim edhe se nuk e dinë shumë por mendoj se do të bëhet mirë atje pra e përkrahim këtë vendim.

**z.Ali Bajrami:** Për vlerën dhe kontributin u elaboruan të gjitha nuk kisha zgjat e kemi diskutuar edhe në KPF atë ditë dhe kemi qenë unanim që të kaloj kjo ajo çka po thehen mendimet sa është vlera atë çka ka bë ai nuk paguhet me pare, prandaj mos të jetë kjo nai problem ose najë pengesë tja rregullojmë bustin siç e meriton dhe siç janë rrethanat dhe kushtet në varrezat e thanës në Tiranë dhe ne si grup parlamentar i LDK-së jemi pro.

**Kryesuesi:** Pasi nuk ka për të diskutuar më e hedhim në votim të pranishëm janë 19 delegat votojmë tash me vota unanime kalon edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Dhe si pikë të fundit të rendit të ditës kemi

## **6. Draft plani për përmbushjen e transparencës në Komunën e Vitisë.**

Ju materialin e keni marrë me kohë dhe un po konsideroj se pjesa dërmuese e pikave që shihen në këtë planë të veprimit për transparencë ka dëshmuar se komuna e Vitisë edhe si

ekzekutiv edhe ne si legjislativ i kemi përmbushur por sidoqoftë un ftoj nënkryetarin e komunës që ta merr fjalën rrethe kësaj pike të rendit të ditës

**z.Hasan Aliu:** Në mungesë të propozuesit që është zyra për informim këtij plani i pa paraprirë rregullorja për transparencën të cilën e keni aprovuar ju vitin e kaluar dhe tash e keni një plan të veprimit që konsideroj që është kanë obligative të del para jush objektiva të cilat i ka paraqit zyrja që e tha kryesuesi shumica prej tyre implementohen, por nuk janë të shkruara prandaj është e udhës të jetë një plan i tillë dhe kisha kërkuar nëse ka ndokush prej juve ka najë vërejtje apo ndonjë plotësim të saj pse mos ta inkorporojmë.

**Kryesuesi:** Faleminderit nënkryetar hapim debat.

**z.Samet Idrizi:** Atëherë pasi është draft plan mendoj plani si planë kur flasim për definicionin plan me sa e di un duhet me pas një vlefshmëri të kohës kjo ndoshta ka qen dashtë mu titullua ndryshe nëse jam gabim sigurisht më përmirëson dikush , tjetra e lexova këtë dhe mendoj se nuk duhet të ngutemi me këtë draft plan mos të veprojmë shpejt e pash se ka të bëjë edhe me dy gjuhësinë un po them pa dashtë me qenë un këtu patriot nëse e shohemi se si komunat serbe përformojnë nëpër komunat e tyre karshi etnitetit Shqiptarë aty konsideroj se nuk duhet të ngutemi me aplikimin e këtij draft plani se nuk po më duket shumë i riformuluar , caktimi i një personi përgjegjës për komunikimin të rregullt në mënyrë elektronike dhe postimit të tyre në vebfaqen e komunës në dy gjuhët zyrtare pyetja ime është se a parashikohet me një kohë të afërt të punësohet një punëtor këtu dhe grupi i PDK- së konsideron se Kryetari ka staf të mjaftueshëm mu mirr me faqen zyrtare të komunës po ashtu edhe me përkthime të gjuhës shqipe në gjuhën serbe dhe nëse pika faqja e fundit un mendoj se duhet të rritet kontrolli edhe përgjegjësia e disiplinës të punëtorëve brenda komunës ka nevojë për trajnime të administratës po nëse e bëjmë një vështrim pas lufte ka pasur shumë trajnime të personelit të administratës që shpesh është menduar se aty janë bërë edhe pastrime të parave përmes këtyre projekteve që nuk kanë dhënë rezultate të mëdha kështu që ta kemi parasysh këtë, kështu që unë mendoj se nuk duhet të ngutemi me këtë draft plan pasi që ndoshta edhe na duhet të presim që të ketë reflektim prej komunave të etnitetit serb veç se nëse na vjen ndonjë urdhër i prerë prej Ministrisë të Pushtetit Lokal, atëherë është tjetër.

**Kryesuesi:** Unë konsideroj se përgjegjësi i zyrës së informimit është ai i cili i përcjell këto çështje dhe e dyta ju e dini se kuvendi i Kosovës e ka miratuar ligjin për dy gjuhësi dhe na si kuvend komunal të gjitha aktet të cilat dalin nga kuvendi jemi obligativë se na obligon ministria që ti i dërgojmë në dy gjuhë dhe kjo po ndodhë dhe për këtë arsye si kuvend kemi një performanc jashtëzakonisht të mirë.

**z.Samet Idrizi:** Na vitin e kaluar e kemi pasur një takim në Letnicë të përbashkët me komunat serbe të regjionit të Gjilanit dhe aty ka komuna se ende nuk e kanë vendosur stemën e Republikës së Kosovës bile ka pasur një komunë që e ka pasur vetëm në qirilicë e as në gjuhë Shqipe jo ka pasur vërejtje të drejtpërdrejta.

**z.Hasan Aliu:** Samet, unë serish do të drejtohem që ne ti kryem detyrat tona të shtëpisë dhe ne jemi përgjegjës për Komunën e Vitisë, ato të cilat ndodhin d.m.th nëpër komunat tjera dhe që bien ndesh me ligjin me siguri janë që mirren prej të parës deri të fundit, prandaj kjo çështje është e rregulluar me ligj.

**Kryesuesi:** Pasi nuk ka më për të diskutuar, e hedhim në votim për miratim, ju lutëm me ngritje dore, 21 këshilltar janë prezent, konsideroj se me 19 vota pro dhe dy kundër miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Dhe në fund ne si kuvend po mendojmë të bëjmë një vizitë studimore 3 ditore në Shqipëri, kisha dashtë që ta marr mendimin e juaj me ngritje dore, pra unanimsisht jemi që të bëjmë një vizitë studimore në Shqipëri, me kaq përfundon seanca, mirë u pafshim në seancat e tjera të radhës

Seanca përfundon punimet në ora 12 : 45

**Procesmbajtës:**  
**Ilir Zuka**

---

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal**  
**z.Naim Pira**

---